

Zhvillohet në Kontrollin e Lartë të Shtetit takimi me përfaqësuesit e Agjencisë Franceze të Zhvillimit

Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së, znj. Marjola Llanaj ka pritur sot në një takim përfaqësues të Agjencisë Franceze të Zhvillimit, zotërinjtë Bernard de Dianous, shef i departamentit të montazhit financiar të projekteve dhe Sébastien Carreau, përgjegjës për zyrën e Tiranës.

Në takim ishte gjithashtu i pranishëm, z. Bledar Doracaj Drejtor i Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në KLSH.



Qëllimi i këtij takimi ishte të kuptuarit e funksionit dhe rolit të KLSH-së në kuadër të auditimit të qeverisjes vendore, si institucioni kryesor i auditimit të jashtëm në kuadër të projekteve që Agjencia Franceze e Zhvillimit do të realizojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri.

Znj. Llanaj duke i falenderuar të pranishmit për interesin paraqiti një kuadër të plotë të rolit dhe të mandatit kushtetues të institucionit duke qenë garanti i përdorimit dhe mirëmenaxhimit të fondeve dhe pasurisë publike, ku pjesë përbërëse është edhe auditimi i njësisve të qeverisjes vendore, vaçanërisht auditimi i hollësishëm që KLSH bën lidhur me pasqyrat financiare të këtyre njësisve lokale.



Znj. Llanaj theksoi gjithashtu, vëmendjen e shtuar që tregohet në rastet e projekteve ku përfshihen kredi, si një detyrim institucional për të garantuar që fondet e akorduara janë përdorur me eficiencë dhe efektivitet për t'u përkthyer më tej, në shërbime sa më cilësore për taksapaguesit shqiptarë.

Përfaqësuesit e të dy institucioneve, shprehën angazhimin e plotë për të vijuar dhe konkretizuar në të ardhmen bashkëpunimin e ndërsjellë, me qëllim trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve duke e konsideruar KLSH-në si një partner i rëndësishëm në mbikqyrjen e jashtme dhe mirëmenaxhimin e fondeve publike.